



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

RELACION

MBI

KËRKESAT BUXHETORE TË PBA 2025-2027

FAZA I-RË

Prill 2024

Përmbajtja

1. Hyrje	3
2. Shpenzimet e personelit.....	8
3. Shpenzime Operative.....	9
4. Shpenzimet për investime.....	14

1. Hyrje

Programi Buxhetor Afatmesëm 2025 - 2027 (në vijim “PBA 2025-2027”) përmban politikën e buxhetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në vijim “Kolegji”), informacion mbi prioritetet, analiza të shpenzimeve, të specifikuara në zëra përkatës. Dokumenti përfshin analizën ekonomike dhe vlerësimet bazë të shërbimeve aktuale, informacion mbi ndarjet e ndryshme dhe fondet që përbëjnë buxhetin. PBA 2025-2027 bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist, sipas VKM-së nr. 184, datë 27.03.2024.

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 28.02.2018, “Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, si dhe udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr. 4, datë 28.02.2024, “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”, po ju parashtrojmë dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për periudhën 2025-2027, faza strategjike, miratuar me vendimin nr. 03, datë 26.04.2024, të Mbledhjes së Gjyqtarëve dhe Grupit për Menaxhimin Strategjik të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas këtij materiali dhe dokumenteve bashkëlidhur.

Kolegji është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si një ndër tre institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Referuar nenit 179/b, pika 5 të Kushtetutës, Kolegji funksionon pranë Gjykatës Kushtetuese, si kolegji i dytë i saj. Gjyqtarët e Kolegjit, referuar pikës 3 të nenit C, të Aneksit të Kushtetutës, gjatë mandatit të tyre gëzojnë statusin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

Në përmbushje të detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji, Kolegji mbështetet nga Njësia e Shërbimit Ligjor dhe punonjësit administrativë. Kuvendi i Shqipërisë, me Vendimin nr. 92/2017, i ndryshuar me Vendimin nr. 35/2024, ka miratuar strukturën organizative, organikën dhe klasifikimin e pagave të personelit të Kolegjit të Apelimit, sipas të cilit, numri total i punonjësve është 63 (gjashtëdhjetë e tre).

Për hartimin e kërkesave buxhetore afatmesme të Kolegjit për fazën strategjike, janë ndjekur këto hapa:

1. Përcaktimi i misionit të institucionit dhe përshkrimi i programit buxhetor;
2. Përcaktimi i qëllimit të politikës dhe objektivave të programit;
3. Përcaktimi i treguesve të performancën për çdo objektiv të programit;
4. Formulimi i produkteve mbi bazën e rezultateve të përcaktuara;
5. Ndarja e kërkesave buxhetore sipas politikave ekzistuese dhe politikave të reja.

Misioni i KPA-së është: *“Përmbushja e funksioneve dhe kompetencave ligjore për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”.*

Kolegji i Apelimit funksionon me një program të vetëm buxhetor me emërtesën: “Veprimtaria e Apelimit të Rivlerësimit Kalimtar”.

Përshkrimi i Programit: *“Mbështetja e veprimtarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; ushtrimin e juridiksionit disiplinor ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj si dhe shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të organeve të sistemit të drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore”.*

Qëllimi i Politikës së Programit: *“Funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”.*

Si tregues i performancës i projektuar për të matur impaktin e këtij qëllimi është përcaktuar: *“Pavarësia dhe funksionimi i sistemit ligjor”.*

Përcaktimi i vlerës bazë, si dhe vlerës për tre vitet e ardhshme, për efekt të procesit të parashikimit të kërkesave buxhetore afatmesme, është kryer duke përdorur si burim informacioni studimet vjetore të publikuara nga “Freedom House”, organizatë e pavarur, financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, e specializuar në studime mbi demokracinë, respektimin e lirive dhe të drejtave si dhe funksionimin e shtetit (<https://freedomhouse.org/country/albania/freedom-world/2024¹>).

Sa i përket vlerësimit të sistemit gjyqësor ky studim paraqet rezultatet në formën e një indeksi me vlera nga 0 - 4, ku nr. 0 paraqet vlerësimin minimal dhe nr. 4 atë maksimal. Në raportin e vitit 2023, ku paraqitet vlerësimi për vitin 2022, sistemi gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, paraqitet në nivelin 2.

Kolegji gjykon se si rrjedhojë e thellimit të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe krijimit e konsolidimit të organeve të reja të drejtësisë në vitet në vijim ky indeks do të vijë drejt një përmirësimi gradual nga niveli 2.5 në vitin 2024, në nivelin 3 deri në vitin 2026.

Për realizimin e programi buxhetor është përcaktuar si objektivi kryesor:

Objektivi 1 - *“Të shqyrtojnë çështjet e ankimuara nën juridiksion, bazuar në një proces të rregullt ligjor”.*

Treguesi i performancës i projektuar për të matur rezultatin e lidhur me këtë objektivi është: *“Numri i çështjeve të përfunduara në raport me numrin e çështjeve të ankimuara”.* Vlera e projektuar, për këtë tregues performance për periudhën 2025-2026, është vlerësuar në masën 57-100%.

Deri më datën 31 dhjetor 2023, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, janë regjistruar për shqyrtim 361 çështje të juridiksionit të rivlerësimit (40 çështje gjatë vitit 2018 , 62 çështje gjatë vitit 2019, 63 çështje gjatë vitit 2020, 86 çështje gjatë vitit 2021 si, 53 çështje gjatë vitit 2022 dhe 57 çështje gjatë viti 2023).

¹ Raporti i plotë narrativ për lirinë në botë 2024 për Shqipërinë do të postohet sapo të bëhet i disponueshëm, ndaj janë paraqitur të dhënat për vitin 2023.

Deri më datën 31 dhjetor 2023, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, janë shpallur 230 vendime të juridiksionit të rivlerësimit ose rreth 64 % e çështjeve të regjistruara.

Si produkt kryesor për realizimin e objektivit 1 është përcaktuar “Çështje të ankimuara /shqyrtuara”, duke parashikuar dhe numrin e çështjeve për periudhën 2025-2027.

Nga të dhënat statistikore të deritanishme, rezulton se janë 805 subjekte rivlerësimi në total. Bazuar në përcaktimet ligjore, të gjitha çështjet e shqyrtuara nga KPK-ja janë potencialisht të mundshme për ankimim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, nga Komisioneri Publik ose subjektet e rivlerësimit. Megjithatë, duke parë trendin e këtyre 6 viteve, si dhe nga të dhënat e deritanishme rezulton se rreth 50% e vendimeve të dhëna nga KPK-ja janë apeluar pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pra, parashikohet që Kolegji në total do të shqyrtojë rreth 403 çështje deri në fund të mandatit të tij. Duke hequr 230 çështje të vendimura deri në fund të dhjetorit 2023, pritet që deri në fund të mandatit të tij, qershor 2026, Kolegji duhet të përmbyllë 173 çështje.

Po kështu, Kolegji ka për kompetencë ligjore dhe shqyrtimin e çështjeve në kuadër të Juridiksionit Disiplinor. Njëkohësisht, në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit, janë paraqitur dhe një numër i lartë i kërkesave me objekt rishikim vendimi, kërkesa këto, të paraqitura nga ish-subjektet e rivlerësimit, të cilëve i ka përfunduar procesi i rivlerësimit në Kolegj.

Sa i takon të drejtës së ushtrimit të juridiksionit disiplinor ndaj subjekteve të përcaktuara në ligj, si dhe shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të organeve të sistemit të drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, aktualisht Kolegji i Apelimit deri në 31 dhjetor 2023 ka shqyrtuar 20 çështje në total, si dhe janë shpallur 9 vendime përfundimtare dhe 9 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare.

Bazuar në sa më sipër, për efekt planifikimi buxhetor, për vitin 2024, është parashikuar si potencialisht të ankimueshme për t'u gjykuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit çështje për të dyja juridiksionet rreth 55 çështje, nga të cilat rreth 45 çështje të Juridiksionit të Rivlerësimit dhe 10 çështje të Juridiksionit Disiplinor. Gjithashtu, parashikohet se mund të ketë edhe kërkesa me objekt rishikim vendimi dhe kërkesa me objekt përjashtim gjyqtari/heqje dorë nga gjykimi. Për vitin 2024 rezultojnë rreth 26 kërkesë për rishikim vendimi, si dhe 56 çështje për përjashtim gjyqtari, me status të pashqyrtuara, që ju përkasin viteve të mëparshme.

Për vitin buxhetor 2025, numri i çështjeve potencialisht të ankimueshme për Juridiksionin Disiplinor parashikohet të ketë rritje, ndërsa për Juridiksionin e Rivlerësimit parashikohet të ketë rritje vetëm kërkesat me objekt rishikim vendimi, pasi këtë vit, për shkak të mbarimit të mandatit të KPK-së, parashikohet që do të ketë ankime ndaj vendimit të KPK-së deri në muajin dhjetor 2024. Pavarësisht mbarimit të mandatit të KPK-së, për vitin 2025 parashikohet përfundimi i çështjeve të regjistruara në vitet e mëparshme në Kolegj, të cilat janë me status të pashqyrtuara, konkretisht parashikohet të përmbyllen rreth 60 çështje të Juridiksionit të Rivlerësimit, duke iu shtuar numrit të këtyre çështjeve edhe numri i çështjeve

me objekt përjashtim gjyqtari/heqje dorë nga gjykimi, të cilat lidhen me to. Për vitin 2026, që është dhe viti i përfundimit të mandatit të Kolegjit, çështje potencialisht të ankimueshme për Juridiksionin e Rivlerësimit, do të jenë vetëm kërkesat për rishikim vendimi, ndërsa për Juridiksionin Disiplinor parashikohet rritje e numrit të çështjeve të këtij juridiksioni, ne krahasim me vitet e mëparshme. Pra, deri në muajin qershor 2026 parashikohet të përmbyllen çështjet e Juridiksionit të Rivlerësimit të regjistruara ndër vit në Kolegj, e konkretisht rreth 53 çështje.

Kërkesa buxhetore për periudhën 2025-2027 është e orientuar në tre zëra shpenzimesh:

1. Shpenzime personeli (paga dhe sigurime shoqërore);
2. Shpenzime operative;
3. Investime.

Parashikimi është kryer duke marrë në konsideratë indeksimin e shpenzimeve me përcaktimet ligjore, normën e inflacionit, çmimet referencë për materialet dhe shpenzimet sipas tregut, si dhe mbështetjen e tyre financiarisht nga burimet ligjore të financimit sipas tavaneve të miratuara.

Buxheti total i parashikuar për mbështetjen e veprimtarisë së Kolegjit të Apelit për vitin 2025 është 308.8 milionë lekë. Tavani buxhetor i përcaktuar për vitin 2025 është 251.4 milionë lekë.

Pavarësisht përcaktimit të mësipërm, në zbatim të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni C, pika 14 e tij, si dhe nenit 19, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kërkesat buxhetore për Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë hartuar bazuar në nevojat konkrete duke argumentuar këto kërkesa, sipas formateve të miratuara në Udhëzimin nr. 7, datë 28.02.2018, të Ministrisë të Financave. Gjithashtu në interpretim të kuadrit ligjor për menaxhimin e sistemit buxhetor faza e parë e përgatitjes së projekt-dokumentit të programit buxhetor afatmesëm njihet si faza strategjike dhe tavanet buxhetore janë të ndryshueshme dhe do të përkthehen në tavane të qëndrueshme dhe të pandryshueshme të shpenzimeve, që duhet të respektohen gjatë fazave në vijim.

Kërkesat buxhetore për Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë hartuar bazuar në nevojat konkrete dhe nuk marrin në konsideratë tavanet indikativë të miratuara për KPA-në, me VKM nr. 184, datë 27.03.2024 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të PBA-së 2025-2027”.

Referuar VKM-së nr. 184, datë 27.03.2024, janë miratuar fonde buxhetore për Kolegjin e Posaçëm të Apelit edhe për vitin 2027, duke marrë parasysh që disa funksione do të vijojnë edhe pasi të pushojë së funksionuari KPA-ja. Nën dritën e këtij fakti është kryer edhe detajimi i fondeve për vitin 2027.


Vlerësimet e shpenzimeve për vitet e ardhshme (viti 2025 dhe 2026 i PBA-së 2024-2026) të miratuara nga Parlamenti si pjesë e Ligjit Vjetor të Buxhetit 2024, janë baza e re për ciklin e përgatitjes së buxhetit 2025-2027, duke argumentuar edhe kërkesat shtesë. U mbajt në konsideratë që kostoja për financimin e politikave ekzistuese nuk do të fillojë çdo vit “nga

zeroja”, por do të përditësohet bazuar në vlerësimin e vitit të mëparshëm duke marrë në konsideratë rrethanat e ndryshuara, duke pasur statistika më të sakta ose informacionit të lidhur me ecurinë e proceseve kryesore të KPA-së.

Tabela më poshtë paraqet një ecuri për vitin 2023, kërkesat dhe tavanet e miratuara për vitin 2024, si dhe tavanet indikativë sipas VKM-së nr. 184, për periudhën 2025-2027

		2023		2024		2025	2026	2027
	<i>në mijë lekë</i>	Ligji nr. 84/2022		Ligji nr. 97/2023		VKM nr. 184 datë 27.03.2024		
Nr.	Emërtimi shpenzimeve	Buxheti fillestar 2023	Realizimi Vitit 2023	Buxheti miratuar për Vitin 2024	Kërkesat shtese nga KPA ne fazën e I PBA 2024-2026	Tavani për vitin 2025	Tavani për Vitin 2026	Tavani për Vitin 2027
1	Pagat dhe Sigurimet shoqërore	181,760	251,413	223,260	7,363	225,760	225,760	225,760
2	Shpenzime të tjera korrente	23,640	12,609	23,640	0	23,640	24,640	25,640
3	Shpenzime kapitale të brendshme	2,000	954	2,000	12,700	2,000	2,000	2,000
	TOTALI	207,400	264,976	248,900	20,063	251,400	252,400	253,400

Figura më poshtë paraqet ecurinë e buxhetit për periudhën 2019-2023. Siç mund të vihet re, duke u bazuar edhe nga fondet e realizuar, aktiviteti i KPA-së ka ardhur në rritje.



Në materialin në vijim, paraqitet në mënyrë të detajuar dhe argumentuar kërkesa për çdo artikull ekonomik, për vitin 2024.

2. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet për paga dhe shtesa të tjera për personelin për vitin 2025, reflektojnë koston aktuale të administratës së KPA-së. Nëpërmjet këtij zëri shpenzimesh garantohet vijueshmëria e strukturave të burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale të tyre në fushat e veprimtarisë së KPA-së, si dhe në sigurinë e mirëfunksionimit të brendshëm administrativ. Kërkesat buxhetore në shpenzime personeli, për vitin 2025, janë përlllogaritur në vlerën totale **266.404 milionë lekë** dhe përfshijnë:

- a) Vlerën **247.604 milionë lekë** paga dhe sigurime shoqërore për 64 (63+1) punonjës të miratuar me Vendimin nr. 92/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, ndryshuar me Vendimin nr. 35/2024, si dhe 1 (një) punonjës me kontratë të përkohshme. Ky fond konsiston përkatësisht në: 226.783 milionë lekë për paga dhe 20.821 milionë lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Në përlllogaritjen këtij fondi jemi mbështetur në:
- Pikat 3, 4 dhe 5, nenin 29 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 17, ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; i ndryshuar, neni 12, ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; i ndryshuar; VKM-ja nr. 574, datë 09.10.2017, “Për përcaktimin e pagës mujore shtesë për shkak të vështirësisë, për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit”; Vendimin nr. 92/2017 të Kuvendit të Shqipërisë, i ndryshuar me Vendimin nr. 35/2024; si dhe Vendimin nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese, sa i takon Gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit, Këshilltarëve të Njesisë së Shërbimit Ligjor.
 - Vendimin nr. 92/2017, të Kuvendit të Shqipërisë, i ndryshuar me Vendimin nr. 35/2024, VKM nr.325, datë 31.05.2023, e ndryshuar VKM nr. 326, datë 31.05.2023, sa i takon punonjësve administrative.
 - Aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për pagesën e kontributit të sigurimit shoqëror dhe kontributit të sigurimit shëndetësor që punëdhënësi kryen për punëmarrësit.
- b) Vlerën **18.8 milionë lekë** në shpenzime personeli ku janë përlllogaritur fondet e kërkuara lidhur me efektin prapaveprues për periudhën mars 2022 - 08 janar 2023, në llogaritjen e pagave dhe sigurimeve shoqërore për gjyqtarët dhe këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, në zbatim të Vendimit nr. 35, datë 22.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e pikës 5, të nenit 12 të ligjit 96/2016. Fondi total është rreth 18.8 milionë lekë, përkatësisht 18.4 milionë lekë në fondin e pagave, artikulli (600) dhe 0.4 milionë lekë në sigurime shoqërore e shëndetësore, artikulli (601).

Për sa i përket shpenzimeve të personelit rezultojnë kërkesa për fonde më të mëdha se tavanit i vendosur.

Për vitin 2026 kërkesa buxhetore për shpenzime personeli janë parashikuar përkatësisht **247.604** milionë lekë. Për vitin 2027 pavarësisht se Institucionet e Rivlerësimit pushojnë së funksionuari, sipas nenit 179/b, pika 9, të Kushtetutës, funksione të caktuara, të cilat do të vijojnë të ushtrohen, si rrjedhim kanë nevojë për parashikim buxhetor në programin “Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar”. Nën dritën e këtij fakti është kryer edhe detajimi i fondeve të shpenzimeve të personelit për vitin 2027.

Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 4, datë 28.02.2024, përcaktohen se, në rastin kur kostoja për financimin e politikave ekzistuese tejkalon tavanin indikativ të alokuar për programin buxhetor të njësisë së qeverisjes qendrore me 3%, pjesa e kostos së tejkaluar e detajuar në nivel programi/objektivi/produkti do të paraqitet si pjesë e propozimeve për politika të reja.

Duke qenë se kërkesa për shpenzimet personelit rezultojnë më e madhe se tavanin i vendosur, në zbatim të udhëzimit të mësipërm, fondet shtesë 40.644 milionë janë paraqitur si politike të reja.

3. Shpenzime Operative

Buxheti për shpenzime operative, përfshin tërësinë e mallrave dhe shërbimeve të domosdoshme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve që Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, i ngarkon Kolegjit të Apelimit.

Në përllogaritjen e fondeve buxhetore për shpenzime operative, jemi mbështetur kryesisht në:

- Treguesit e realizuar të shpenzimeve operative për vitin 2021 - 2023 dhe shpenzimeve të parashikuara për vitin 2024, si dhe kërkesat specifike të paraqitura nga dy drejtoritë. Në parashikimin e këtyre shpenzimeve, të cilat kanë rëndësi për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve operacionale, u morën parasysh nevojat e administratës, numri i personelit, shpenzimet e automjetit, amortizimi dhe zëvendësimi i pjesëve të konsumueshme të pajisjeve, konsumi mesatar i karburantit dhe aktiveve qarkullues etj.

Buxheti total i parashikuar në shpenzime operative për vitin 2025, sipas taveve indikativë për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit është 23.64 milionë lekë, ndërsa kërkesat e Kolegjit për shpenzime operative janë në vlerën 27.65 milionë lekë ose pothuajse sa tavanin i vendosur, sipas VKM-së nr. 195, datë 05.04.2023 (faza e parë PBA 2024-2026).

Në vijim, janë paraqitur kërkesat për vitin 2025, sipas grupeve kryesore të shpenzimeve operative:

602.0 - Materiale dhe shërbime zyre të përgjithshme

Kjo kategori shpenzimesh e përllogaritur në vlerën **2.7 milionë** lekë përfshin zërat e mëposhtëm:

në 000 lekë

Nr. Materiale zyre dhe të përgjithshme	2,700
---	--------------

1	Kancelari, letër	700
2	Materiale për pastrim e higjeno-sanitare	600
3	Materiale elektrike, ndriçim etj.	100
4	Shërbime printimi	1,200
5	Materiale për funksionim pajisjeve speciale	50
6	Furnizim dhe materiale tjera zyre dhe të përgjithshme	50

Në zërin materiale për funksionimin e zyrave janë parashikuar nevojat vjetore për vitin 2025, të cilave do të blihen sipas rregullave të prokurimit publik të procedurave, që do të zhvillohet në vitin 2025 dhe një pjesë do të jenë kontaktuar gjatë vitit 2024, po sipas rregullave të prokurimit publik.

602.1 - Materiale dhe shërbime speciale

Kjo kategori shpenzimesh e përllogaritur në vlerën **745 mijë** lekë përfshin zërat e mëposhtëm:

në 000 lekë

Nr.	Materiale dhe shërbime speciale	745
1	Uniforma dhe veshje të tjera speciale	25
2	Ilaçe dhe materiale mjekësore	10
3	Furnizime me ujë të pijshëm për seancat dhe personelin	300
4	Posta abonim në shtypin e shkruar	100
5	Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik Vendimesh, dosje gjyqësore etj.)	150
6	Dezinfektim i ambienteve	60
7	Të tjera materiale dhe shërbime speciale	100

- Në zërin ujë i pijshëm, është parashikuar mbulimi i nevojave për personelin e Kolegjit, si dhe palët pjesëmarrëse gjatë proceseve gjyqësore.
- Në zërin dezinfektim i ambienteve, është planifikuar dezinfektimi kundër insekteve që mbartin patogjenë të dëmshëm për shëndetin e njeriut me një frekuencë 3 herë/vit.

602.2 - Shërbime nga të tretët

Kjo kategori shpenzimesh e përllogaritur në vlerën **3.795 milionë** lekë përfshin zërat e mëposhtëm:

në 000 lekë

Nr.	Shërbime nga të tretët	3,795
1	Elektricitet	1,600
2	Ujë	90
3	Shërbime telefonike	1,000
4	Posta, shërbim korrieri	200
5	Shërbime bankare	5
6	Shërbime të printimit dhe publikimit	600
7	Kosto e trajnimit dhe seminareve	150
8	Shërbim interneti për ambientet me qira	50

- Në zërat elektricitet dhe ujë, përveç konsumit në godinën aktuale, është parashikuar dhe konsumi për ambiente shtesë të marra me qira në dispozicion të Kolegjit.
- Në zërin kosto të trajnimit dhe seminareve, janë parashikuar trajnime për stafin administrativ të organizuara nga institucione të licencuar dhe të akredituar nga organet e administratës.
- Në zërin shërbime telefonike, në zbatim të VKM-së nr. 855, datë 02.11.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 02.09.2020, “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë”, si dhe Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020, i cili ka miratuar kuotat maksimale për telefoninë celulare, sipas funksioneve, është llogaritur vlera e kontratës institucionale për titullarin e institucionit, këshilltarët ligjorë dhe ekonomikë, Sekretarin e Përgjithshëm dhe drejtorët e Drejtorive.
- Zëri shërbime printimi dhe publikimi ka të bëjë me publikimet në mediane dhe shkruar dhe atë *online* të pozicioneve vakante të punësimit për shtesat në strukturë, si dhe pozicionet vakante që mund të krijohen gjatë vitit në institucion.

602.3 - Shpenzime transporti

Kjo kategori shpenzimesh e përlllogaritur në vlerën **560 mijë lekë** përfshin zërat e mëposhtëm:

		<i>në 000 lekë</i>
Nr.	Shpenzime transporti	560
1	Karburant dhe vajra	250
2	Pjesë këmbimi, goma dhe bateri	50
3	Shpenzime siguracioni të mjeteve	60
4	Shpenzime të tjera transporti (parkim për automjetin e institucionit)	200

- Në zërin karburant gjatë vitit 2025, është parashikuar një sasi prej 1200 litër (100 litër/muaj), për automjetin e institucionit, por që është në varësi të procedurës së prokurimit.
- Në zërin “pjesë këmbimi, goma dhe bateri”, me vlerë 50 mijë lekë, është vlerësuar prokurimi i pjesëve që mund të dëmtohen për automjetin e institucionit, të cilat nuk klasifikohen si shërbime, sipas vlerësimit të kryer nga shoferi i automjetit ose nga kontrolli që i kryhet automjetit, përpara se të kalojë kontrollin vjetor.
- Në zërin shpenzime të tjera transporti, është përfshirë rinovimi i kontratës me Bashkinë Tiranë për vend parkimin e automjetit të institucionit.

602.4 - Shpenzime udhëtimi

Kjo kategori shpenzimesh e përlllogaritur në vlerën **3 milionë lekë** përfshin zërat e mëposhtëm:

		<i>në 000 lekë</i>
Nr.	Shpenzime udhëtimi	3,500
1	Udhëtim i brendshëm	1,000

- Lidhur me udhëtimet e brendshme, është parashikuar një fond, duke u bazuar në nenin 49, pika Ç e ligjit 84/2016, ku parashikohet se me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Kolegji ka të drejtë të këqyrë dhe kontrollojë sende të luajtshme apo të paluajtshme, bazuar në vendimin e gjykatës kompetente, si dhe zhvillimi i dy seminareve brenda Shqipërisë, në kuadër të juridiksionit disiplinor.
- Në zërin udhëtime jashtë vendit nisur nga fakti që anëtarët e Kolegjit, mund të marrin pjesë në konferenca të ndryshme ndërkombëtare, takime apo trajnime me organe të juridiksionit disiplinor, për proces të rregullt gjykimi e shkëmbim eksperience, është parashikuar mbulimi i shpenzimeve për 1 (një) udhëtim 3-ditor për shtatë gjyqtarë për vizita studimore në gjykata homologe; 1 (një) udhëtim 4-ditor për 14 (katërmëdhjetë) këshilltarë në Njesisë së Shërbimit Ligjor për trajnim në kuadër të Juridiksionit Disiplinor në GjEDNJ apo gjykata evropiane, të cilat kanë në juridiksionin e tyre procedime disiplinore. Gjithashtu, në këtë zë është përfshirë dhe një udhëtim 3-ditor për personelin (3 persona/udhëtim) për takimet vjetore të Komitetit të Stabilizim-Asociimit, në Bruksel. Baza ligjore për shpenzimet e parashikuara më sipër është VKM-ja nr. 870, datë 14.11.2011, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 22, datë 10.07.2013, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 870, datë 14.12.2011, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

602.5 Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme

Kjo kategori shpenzimesh e përllogaritur në vlerën **1.3 milionë lekë** përfshin zërat e mëposhtëm:

		<i>në 000 lekë</i>
Nr.	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	1,300
1	Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemeve dhe instalimeve teknike	100
2	Shpenzime për mirëmbajtje të mjeteve të transportit	100
3	Shpenzime për mirëmbajtje e pajisjeve të zyrave	1,100

Në zërin mirëmbajtje për mirëmbajtje të zakonshme janë përfshirë:

- Mirëmbajtja e serverëve, kompjuterëve dhe pajisjeve të zyrës të institucionit, në vlerën 1,100 mijë lekë, si vijim i marrëveshjes kuadër që aktualisht është në fuqi deri në muajin gusht 2024, si edhe procedurës që do të zhvillohen gjatë vitit 2024. Në shpenzime për mirëmbajtjen e sistemeve dhe instalimeve teknike ku përfshihen: mirëmbajtja vjetore e sistemit audio-video të instaluar në sallën e gjyqit, si dhe mirëmbajtja e kondicionerë të dhomës së serverave.
- Shpenzime për mirëmbajtje të automjetit të institucioni, ku përfshihen shërbimeve rutinore dhe ato të parashikuara në momentin e hartimit të planit.

602.6 - Shpenzime për qiramarrje ambientesh

Buxheti i detajuar për këtë kategori shpenzimi është përlogaritur në vlerën **2.04 milionë lekë** dhe përfshin pagesën vjetore për kontratën së qirasë për ambientet shtesë, në përdorim të Kolegjit. Kontrata aktuale përfundon në muajin shtator 2024 dhe parashikohet të lidhja e kontratës për periudhën në vijim. Në lidhje me këtë zë, sqarojmë se është parashikuar me rritje prej 20% të shpenzimeve të qirasë të zyrave, sipas kontratës aktuale, e cila ndodhen në adresën: Blv. “Bajram Curri”, Pallatet Agimi, me numër pasurie 3/163+2-2. Në këto ambiente, përvës se janë pozicionuar përkthyesit dhe zyrat e financë/personel, është edhe magazina e institucionit. Këto ambiente, siç edhe jeni në dijeni, janë në një distancë relativisht jo shumë të afërt me zyrat qendrore, distancë kjo që krijon vështirësi funksionale, që reflekton në ulje të efektivitetit të punës nga lëvizjet e shpeshta gjatë orarit të punës. Në këto kushte, kërkohet një rritje nga fondi aktual, me qëllim përshtatjen e zyrave afër me godinën qendrore, duke rritur bashkëpunim midis strukturave të KPA-së.

602.9 - Shpenzime të tjera materiale dhe shërbime operative

Kjo kategori shpenzimesh e përlogaritur në vlerën **13.005 milionë lekë** përfshin zërat e mëposhtëm:

<i>në 000 lekë</i>		
NR.	Shpenzime të tjera operative	13,005
1	Shpenzime për sigurimin e jetës, shëndetit dhe pronës	10,985
2	Shpenzime telefonie për funksionarët e institucionit	1,100
3	Shpenz. kompes. për zyrtarët e zgjedhur (pasaportë diplomatike)	60
4	Shpenzime për tatim & taksa të paguara nga instit.	50
5	Blerje licencash Firewall	600
6	MKZ	20
7	Blerje materiale hidraulike, marangozi, ndërtimi etj.	60
8	Dekorim i festave të fundvitit	10
9	Mirëmbajtje faqe zyrtare	120

- Në zërin sigurimi i jetës, shëndetit dhe pasurisë, bazuar në pikën 17, të nenit C të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 25 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është parashikuar një fond 10.985 milionë lekë. Fondi prej 8.085 milionë lekësh i dedikohet paketës së sigurimi të shëndetit për gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, personat e lidhur të gjyqtarëve, këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorët e Drejtorive, stafin administrativ dhe sigurimin e pasurisë. Fondi prej 2.9 milionë lekësh i dedikohet paketës së sigurimit të jetës për gjyqtarët, personat e lidhur të gjyqtarëve, këshilltarët e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Drejtorët e Drejtorive.

Këto vlera kanë rezultuar nga kontrata e lidhur në vitin 2023 për sigurimin e jetës dhe nga studimi i tregut gjatë vitit 2024, për sigurimin e shëndetit dhe pasurisë.

Nga studimi i tregu në fund të vitit 2023, rezultoi se për vitin 2024 do të duhej të shtohet dhe u shtua vlera prej 2.285 milionë lekësh, duke pakësuar shërbimet e tjera kryesisht *shpenzime udhëtimi* dhe *shërbime nga të tretë*, për të cilat do të duhet të paraqesim shtesë fondi për vitin 2024, sipas procedurave të udhëzimit të Ministrit të Financave për zbatimin e buxhetit.

- Në zërin shpenzime telefonie për Gjyqtarët dhe Njësinë e Shërbimit Ligjor, është parashikuar fond 15 mijë lekë/muaj, për mbulimin e shpenzimeve telefonike për kontratat individuale të gjyqtarëve të Kolegjit, bazuar në VKM-në nr. 855, datë 02.11.2020 dhe Vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 28, datë 21.12.2020, si dhe kontratat aktuale të gjyqtarëve. Sqarojmë këtu që zëri “*Shërbime telefonike*”, që paraqitet në llogarinë 602.2, përfshihen pagesat që kryhen nga institucioni ndaj kompanisë celulare duke u bazuar në kontratën që lidh Kolegji me kompaninë, ndërsa në këtë zë (602.9) paraqiten pagesat që rimbursohen për mbulimin e shpenzimeve telefonike për kontratat individuale të gjyqtarëve të Kolegjit dhe Njësisë së Shërbimit Ligjor.
- Në zërin blerje licencash, përveç rinovimit të shërbimit Microsoft Office 365, është përfshirë dhe rinovimi i shërbimit *Zoom Meeting* për punën në distancë.

Kërkesa për shpenzime operative për vitin 2025, në vlerën 23.64 milionë lekë është konsideruar si pjesë e politikës ekzistuese të Kolegjit të Apelimit dhe në vlerën 4 milionë është konsideruar si pjesë e politikës së re.

Për vitin 2026, kërkesa buxhetore për shpenzime korrente është **përcaktuar 274.75 milionë lekë** dhe nuk është parashikuar rritje për nivelin e inflacionit, sipas përcaktimeve në udhëzimin për hartimin e kërkesave buxhetore afatmesme dhe janë zbritur shpenzime që nuk konsiderohen të domosdoshme gjatë kësaj periudhe. Për vitin 2027, pavarësisht se Institucionet e Rivlerësimit pushojnë së funksionuari, sipas nenit 179/b, pika 9 e Kushtetutës, funksione të caktuara, të cilat do të vijojnë të ushtrohen, kanë nevojë për parashikim buxhetor në programin “Veprimtaria e apelimit të rivlerësimit kalimtar”. Nën dritën e këtij fakti është kryer edhe detajimi i fondeve të shpenzimeve të operative për vitin 2027, duke u bazuar në tavanet indikativë të miratuar, sipas VKM-së nr.184, datë 27.03.2024.

4. Shpenzimet për investime

Për vitin 2025, Kolegji i Posaçëm të Apelimit ka parashikuar në investime fondin **13.4 milionë lekë**. Tavani buxhetor i përcaktuar për vitin 2025 është 2 milionë lekë.

Për vitin 2025 është programuar blerja e pajisjeve të tjera të cilat mund të jenë të nevojshme, por që gjatë hartimit të dokumentit të PBA-së nuk mund të parashikohen ose zëvendësimi i pajisjeve të cilat janë amortizuar apo shfaqin probleme gjatë vitit 2025, si dhe *Scanner për kontroll dhe urë metal dedektor*.

Sa i takon shpenzimeve për investime, bazuar në kërkesat për investime të paraqitura nga dy drejtoritë, përdorimi i këtij fondi për vitin 2025, parashikohet si më poshtë:

1. Blerje pajisje zyre të nevojshme për personelin. Parashikimi për këtë grup investimesh është llogaritur në vlerën 1,000 mijë lekë.
2. Blerje pajisje elektronike/UPS etj., për rastet e dëmtimeve gjatë vitit, të cilat nuk mund të riparohen dhe nevoja të tjera që mund të shfaqen gjatë vitit.

Parashikimi për këtë grup investimesh është llogaritur në vlerën 1,000 mijë lekë.

Bazuar në përcaktimet e udhëzimit për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm, kjo kërkesë është trajtuar në kategorinë shpenzime administrative kapitale dhe përfshihet në politikat ekzistuese për projektet e investimeve publike.

3. Scaner për kontroll dhe urë metal detektor, në vlerë 12,7 milionë lekë. Kjo është një kërkesë e përsëritur e Kolegjit prej vitit 2019, e cila nuk është miratuar. Theksojmë se ky investim garanton sigurinë e personelit të Kolegjit, si dhe të palëve pjesëmarrëse në proces. Bazuar në përcaktimet e udhëzimit për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm, kjo kërkesë është trajtuar në kategorinë shpenzime për projekte investimesh dhe përfshihet në politikat e reja për projektet e investimeve publike.

Bashkëlidhur, lutem gjeni formatet standarde për hartimin e kërkesave buxhetore afatmesme 2025-2027.

Duke ju falënderuar për vëmendjen.

KRYETARI

Sokol Çomo

Konceptoi: E. Pojani
Nr. Kopjeve: 2 (dy)
Data: 30.04.2024